



Thirrje: „Gjuhët e para të fëmijëve të përkrahen – një detyrë qendrore e arsimit publik“

Përse një thirrje për këtë temë?

- Shumëgjuhësia është një realitet shoqëror. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë pjesën e tyre në të dhe të përfitojnë nga kjo.
- Të trashëgosh gjuhën, të mësosh gjuhët dhe të mbash gjuhët e t'i zhvillosh më tutje, do të thotë të përvetësosh aftësitë, të cilat shkojnë më larg se sa ajo që zakonisht mendohet me njohuritë gjuhësore. Kjo do të thotë një konfrontim me përmbajtjet, konceptet mbi botën, kulturat. Lidhjet e ndërsjella me aftësi mendimi, socializimi dhe formimi i identitetit duken qartë. Gjuha dhe gjuhët janë vetvetiu bazë për komunikim dhe për mësim. Për këtë arsye, është një detyrë qendrore e fushës arsimore, që të përkrahet të mësuarit e gjuhëve, vazhdimisht dhe në çdo aspekt.
- Dhënia e njohurive në gjuhën shkollore lokale ka një prioritet të lartë. Kompetenca në këtë gjuhë është e rëndësishme, që të mund të ekzistohet në shoqëri. Ashtu siç tregojnë studimet, është e nevojshme që shkolla të përmirësojë edhe më tutje përkrahjen e fëmijëve dy- dhe shumëgjuhësorë në gjuhën shkollore lokale. Me një diferencim kuptimplotë, mësimi mund t'i arrijë nxënësit me paranjohuri të ndryshme. Mësimi i gjuhëve të ndryshme mund të ndërlihet bashkërisht përmes zhvillimit të një didaktike shumëgjuhësore.
- Fëmijët, gjuha e parë e të cilëve nuk është gjuhë shkollore, mësojnë gjuhën shkollore si gjuhë të dytë, nganjëherë edhe si gjuhë të tretë apo të katërt. Familjet e tyre kanë emigruar, ose kanë ndërruar vendbanimin nga një pjesë e vendit në pjesën tjetër, ose prindërit e tyre flasin gjuhë të ndryshme. Këta fëmijë rriten si fëmijë dy -ose shumëgjuhësorë. Kjo do të mund të ishte një përparësi, por sot ndikon shpesh si pengesë, veçanërisht tek fëmijët dy –ose shumëgjuhësorë të punëtorëve emigrantë. Kjo ndikon në mbipërfaqësime në degët e ulta të shkollës sekondare I dhe në klasët e veçanta si dhe në nënpërfaqësime në shkollat e mesme dhe në mësimin e profesioneve me kërkesa të larta. Shkolla publike, mund ta përmbush kërkesën e saj, për të qenë shkollë për të gjithë, nëse e menjanon këtë diskriminim strukturor.
- Mësimi në gjuhën e parë i përkrahë fëmijët dy-ose shumëgjuhësorë dhe familjet e tyre, në atë që të zhvillojnë gjuhën e tyre, të menduarit dhe të vepruarit e tyre, të ndërtojnë një identitet të fortë dhe me këtë të arrijnë një sukses të mirë shkollor.



- Për fëmijët e rritur në ambient dy –ose shumëgjuhësorë dhe familjet e tyre, por edhe për njerëzit e rritur në ambient njëgjuhësor, është me përparësi, nëse fusha e arsimit e përkrah dy-dhe shumëgjuhësinë. Arsimi shumëgjuhësor e mundëson komunikimin në shumë fusha, ai ofron shansa për një bashkëjetesë multikulturore dhe të punës, në Zvicër dhe në botë.
- Mësimi shkollor i gjuhës së parë dhe i gjuhëve të tjera është një e drejtë njerëzore.
- Është në interes të gjithë shoqërisë, që njerëzve të emigruar t'ua ofrojë një arsimim të mirë, edhe në gjuhët e tyre që kanë sjellë me vete. Kjo nuk është vetëm një pasuri multikulturore por edhe me dobi të shumtë ekonomiko-politike. Financimi publik i mësimit në gjuhët e para (deri tash të përceptuara nga “Kurset e gjuhës dhe kulturës së Atdheut”) është edhe nga këto arsye i përligjur.
- Mësimi në gjuhët e ndryshme të para (“Kurset e gjuhës dhe kulturës së Atdheut”) i forcon kompetencat gjuhësore dhe vetëdijen personale të fëmijëve. Në bazë të përvojave ndërtimi i vetëdijes personale është edhe një kontribut për integrim dhe preventivë ndaj dhunës. Në këtë kuptim një mësim i tillë ka një ndikim të madh integrues në një fushë shkollore të ndikuar nga monolingualizmi dhe kontibuon shumë për një “klime shkollore” të mirë.
- Institucioni shkollë, përmes njohjes së plotë dhe vlerësimit të shumëgjuhësisë (dhe jo vetëm të asaj “elite arsimore”) mund të forcojë në mënyrë masive ndikimin pozitiv të tyre.

**Thirrje “Gjuhët e para të fëmijëve të përkrahen –
një detyrë qendrore e arsimit publik”**

- **Organizatave të bashkuara dhe personat veç e veç janë të bindur, që shumëgjuhësia në Zvicër, e cila përbëhet nga katër gjuhë vendore dhe shumë gjuhë të tjera, paraqet një potencial të madh dhe se duhet të jetë një çështje qendrore e fushës arsimore zvicerane që ta zhvillojë këtë shumëllojshmëri gjuhësore.**
- **Ata kërkojnë me tërë forcën nga përgjegjësit arsimorë dhe të politikës gjuhësore në federatë, në EDK, te kantonet dhe komunat që ta shfrytëzojnë përgjegjësinë e tyre në aspektin përmbajtësor,**



ligjor, organizativ dhe financiar dhe në bashkëpunim me bartësit mësimin e deritashëm në gjuhët e ndryshme të para ("Kurse e gjuhës dhe kulturës së Atdheut") ta integrojnë në shkollën publike.

- **Ata e përshëndesin vendimin e Konferencës Zvicerane të Drejtorëve të Edukimit (EDK) që përkrahja e Kurseve GJKA nga ana e kantoneve përmes masave organizative të merret në Konkordatë Harmos dhe e vlerësojnë këtë si një hap të rëndësishëm në drejtim të duhur. Ata kërkojnë nga kantonet që ta konkretizojnë sa më shpejt këtë përkrahje. Nga EDK kërkohet që të organizojë një instancë, e cila në këtë fushë do të bëjë një përkrahje të suksesshme koordinative qendrore në shërbim të kantoneve.**

Bashkësia e Interesit për Mbështetjen e Gjuhëve të Para kërkon nga Federata, nga EDK-a, nga kantonet dhe komunat:

1. Institucioni shkollë ta njuhë patjetër shumëgjuhësinë dhe t'i mbështesë gjuhët e ndryshme, duke i trajtuar ato si pjesë thelbësore të veprimtarisë së saj. Mbështetja e gjuhës duhet të jetë pjesë përbërëse e programit normal të shkollës. Ajo nuk duhet të jetë më çështje periferike. Ajo duhet të jetë në dispozicion për të gjithë të interesuarit. Qëllimi i shumëgjuhësisë është zhvillimi i kompetencës së nxënësve në shumë gjuhë dhe përkrahja e integritit të nxënësve që flasin një e më shumë gjuhë në shkollë dhe në shoqëri.
2. Të gjitha kantonet duhet ti konkretizojnë, zgjerojnë ose t'i inicojnë masat mbështetëse për mësimin plotësues në gjuhën e fëmijëve migrantë sipas nenit 4 të Harmos-konkordatit. Hapi i parë i patjetërsueshëm në këtë drejtim është përfshirja e mësimin plotësues në orarin e rregullt, zhvillimi i tij në mësojtoret e rregullta, vënia në dispozicion e materialit të nevojshëm shkollor dhe vënia-shënimi i suksesit të arritur në dëftesat e shkollës së vendit.
3. Hapat tjerë, të cilët pa u vonuar fare, duhet të ndërmerren në kuadër të detyrave reformuese të Harmos-Konkordatit janë:
 - A Prej kohës kur fëmijët shkojnë në shkollë, në institucione mbështetëse për familjet me fëmijë të moshës parashkollore, në kopshtet e fëmijëve (ciklin bazik) është shumë me rëndësi që gjuhët e para të fëmijëve të përkrahen në mënyrë të vetëdijshme. Kjo duhet të vazhdohet edhe më tej që gjuha e parë e fëmijëve të bëhet pjesë përbërëse e shkollës publike deri në ciklin sekondar II, kurse si lëndë zgjedhore gjuhët e para duhet të ofrohen edhe në shkollat e mesme të zëjtarisë dhe mundësisht edhe në shkollat e mesme me maturë dygjuhësore. Njohuritë e fituara dhe suksesi i arritur i nxënësve në gjuhët e tyre të para duhet të shënohet dhe të certifikohet (notat në dëftesë, portfolio gjuhësore, certifikatë etj.). Këto njohuri të nxënësve duhet të merren parasysh për arsimimin e tyre të ardhshëm dhe karrierën e tyre.



- B Në programet përkrahëse të të gjitha cikleve shkollore duhet ta kenë vendin e tyre të merituar edhe gjuhët e para. Fjala është për elementet si ELBE (éveil au langage et ouverture aux langues, langues awareness, Begegnung mit Sprachen), Portfolio e gjuhëve, konceptet e didaktikës integrative, didaktika e koordinuar në arsimimin e mësuesve. Në veçanti mësimi në gjuhët e para të fëmijëve duhet të përfshihet edhe në plan-programet mësimore rajonale, të cilët duhet të zhvillohen mbi bazat e Harnos-konkordatit.
- C Mësimi i gjuhës në të gjitha lëndët e gjuhëve të shkollës publike dhe mësimi në gjuhët e para (kurset e gjuhës dhe kulturës së prejdardhjes) e plotësojnë njëri-tjetrin dhe për atë duhet të jenë në përputhje me njëri-tjetrin p.sh. me një plan-program mësimor kornizë, me një qëndrim të përbashkët pedagogjik mbi mësimin e gjuhëve dhe përkrahjen e shumëgjuhësisë. Mësimdhënësit e gjuhëve të para (të kurseve të gjuhës dhe kulturës së prejdardhjes) posedojnë resurse dhe kompetenca të duhura. Përmes programeve dhe projekteve të bashkëpunimit me shkollat publike këto kompetenca mund të verifikohen dhe të shfrytëzohen.
- D Për t'u zotuar pretendimeve të reja nevojiten kushte të duhura për mësimdhënësit. Me rëndësi janë, në radhë të parë, marrëveshjet e punës të barazvlerëshme mes mësuesve dhe programet e mjaftueshme për përsosje profesionale të tyre. Për zhvillimin e shkollës publike drejt shumëgjuhësisë është e patjetërsueshme vënia në dispozicion e resurseve dhe mjeteve të nevojshme financiare. Shkollat e larta pedagogjike, universitetet dhe e planifikuara "Qendra kompetente për gjuhët" janë përgjegjëse që të kujdesen për fushën e shumëgjuhësisë, për mësimdhënien në gjuhët e para të ndryshme, për arsimimin e përsosjen profesionale të mësimdhënësve të të gjitha cikleve dhe për hulumtimet e duhura. Për këtë është e nevojshme bashkëpunim i ndërsjellë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe kreditë e duhura për hulumtime e zhvillime.
4. Përfundim: Ardhmëria e shkollës publike, e cila e aplikon të drejtën për shkollimin e të gjithëve qëndron në shumëgjuhësinë. Kjo mund të jetësohet në qoftë se fusha e arsimit publik do ta merr përgjegjësinë e plotë ligjore, organizative e financiare në bashkëpunim me vendet nga vijnë migrantët dhe organizatat e komuniteteve të ndryshme gjuhësore. Për shkollën e detyrueshme publike kjo duhet të bëhet në kuadër të aplikimit të Harnos-Konkordatit.

Plotësuar dhe miratuar nga mbledhja e formimit të Bashkësisë së Interesit për Mbështetjen e Gjuhëve të Para më 22 shtator 2007